



**MISIONI PËR VËZHGIN E ZGJEDHJEVE  
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS**

---

*PER PUBLIKIM TE MENJEHERSHEM*

Prishtinë, 12 janar 2011

**PARREGULLSITE NDIKOJNE NE BESIMIN E PROCESIT  
DEMOKRATIK NE KOSOVE**

Numri i madh i parregullsive gjatë zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës kanë ndikuar dukshem në besimin e procesit demokratik në Kosovë.

Thyerja e fshehtësisë së votës përmes votimit familjar ose në grup, ka qenë rregull dhe jo përjashtim në shumë vende, gjë që është raportuar nga vëzhguesit e ENEMO-s në 38% të vendvotimeve të vizituara në rivotimin e 9 janarit. Këto shkelje serioze të procedurës duket se janë pranuar dhe nuk kishte përpjekje nga personeli i vendvotimeve për ndalimin e sjelljes së parregullt zgjedhore. Incidentet e ngjashme dhe pretendimet për veprime mashtruese në zgjedhjet e 12 dhjetorit japin pasqyrë të zymtë për ardhmërinë e proceseve demokratike në Kosovë. Më tej, rastet e frikësimit dhe presionit mbi vëzhguesit vendas janë raportuar në ENEMO, duke iu shtuar dobësive tjera gjatë procesit.

Pas procesit zgjedhor të 12 dhjetorit 2010, Paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtrësia (PZAP) ka përcjellë mbi 100 ankesa në prokurori për hetim të mëtejshëm. Për ta rritur nivelin e besimit në këtë proces, Misioni ENEMO i nxit autoritetet që ta sigurojnë hetimin për të gjitha rastet e lidhura me mashtrimet zgjedhore, duke i ndjekur dhe kërkuar përgjegjësi në kohën e duhur nga ata që kanë kryer vepra të këtilla. Për ta ndryshuar kuptimin e mosndëshkimit të mashtrimeve zgjedhore, është me rëndësi qenësore që të gjitha rastet e 12 dhjetorit 2010, si dhe rastet e mbetura të vitit 2007 dhe 2009 të trajtohen në mënyrë efikase dhe transparente.

Për zgjedhjet e 9 janarit, Komisioni qendror zgjedhor (KQZ) dhe Sekretariati i kanë menaxhuar në mënyrë të kënaqshme të gjitha aspektet teknike të procesit zgjedhor me materialet e rëndësishme dhe të ndjeshme, në kohën e duhur. Mbledhjet e këshillit të KQZ-së kanë qenë të hapura dhe janë vijuar nga vëzhguesit dhe përfaqësuesit e mediave. Por, puna e KQZ-së është ndikuar nga përkatësia partiake e anëtarëve të Komisionit. Nevojitet përforsimi i mëtejshëm i integritetit të KQZ-së në procesin e vendim-marrjes, përmes zvogëlimit të ndikimit të partive politike mbi punën e saj.

ENEMO e nxit Grupin punues për zgjedhje të vazhdojë me punë, me qëllim të reformimit të kornizës ligjore. Autoritetet e Kosovës nxiten për sigurimin e zbatimit efikas të ligjeve, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë zgjedhore.

**Për më tepër informata, ju lutemi kontaktoni:**

**Gazmend Agaj**

**Oficer për shtyp**

**Adresa: Andrea Gropa nr.30, Prishtinë**

**Tel: +386(0)49 – 157 729**

**Email: [gazmend.agaj@enemo.eu](mailto:gazmend.agaj@enemo.eu)**

**[www.enemo.eu](http://www.enemo.eu)**

*Në vijim të ftesës së Ushtruesit të detyrës së Presidentit Jakup Krasniqi, Rrjeti evropian i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve (ENEMO) e ka themeluar Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës më 12 dhjetor 2010. Ekipi kryesor i ENEMO-s ka arritur më 21 nëntor 2010, duke i filluar përgatitjet dhe vendosjen e 12 vëzhguesve afatgjatë në 6 ekipe në mbarë territorin e Kosovës. Ata e kanë vëzhguar klimën parazgjedhore, përfshirë edhe fushatën politike dhe aktivitetet e administratës zgjedhore, para zgjedhjeve të 12 dhjetorit. Në ditën e votimit, ENEMO ka dërguar 188 vëzhgues të zgjedhjeve nga 23 shtete në 861 vendvotime, në të gjitha komunat e Kosovës.*

*Në vijim të vendimit të Komisionit qendror zgjedhor për përsëritjen e votimit në tre komuna dhe dy qendra tjera të votimit, ENEMO ka ridërguar tre anëtarë të Ekipit kryesor dhe 4 vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e klimës parazgjedhore, rivotimit dhe numërimit, si dhe zhvillimeve pas-zgjedhore. Më 9 janar 2011, shtatë ekipe vëzhguese kanë vizituar 60 vendvotime në të gjitha komunat ku është përsëritur votimi.*

*Zgjedhjet vlerësohen në bazë të standardeve ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionit nacional. Kjo deklaratë e konstatimeve dhe përfundimeve paraprake dorëzohet para përfundimit të procesit zgjedhor, duke e përfshirë edhe procesin e mbledhjes në tabela dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare, si dhe menaxhimin e ankesave ose parashtrësive të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. Këto konstatime dhe përfundime janë paraprake dhe misioni do të vazhdojë me vëzhgimin e procesit të mbledhjes së rezultateve në tabela dhe procesit të ankesave dhe parashtrësive. ENEMO do të publikojë raport mbarëpërfshirës përfundimtar brenda një muaji, ku do të përfshihen edhe rekomandimet për përmirësimet e mundshme.*